



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 5 shkronja c), 11, 12.2 shkronja d) dhe 17 shkronja f) të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, nenin 5.2 të Ligjit 03/L-087 për ndërmarrjet publike, Ligjit nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike nr.03/L-087, nenin 3 paragrafi 1.3, nenet 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenin 19 paragrafi 1.6 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 31 mars 2026, miratoi këtë,

V E N D I M

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE - STACIONI I AUTOBUSËVE PODUJEVË SH.A

Neni 1

1. Ngritet Komisioni Komunal i Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale - Stacioni i Autobusëve Podujevë Sh.A. në përbërjen si vijon:

z.Valdet Kamerolli, i emëruar nga Kuvendi i Komunës
znj.Luljeta Muqolli-Azemi, e emëruar nga Kuvendi i Komunës

2. Kryetari i Komunës me vendim të veçantë emëron një anëtar/e në kuadër të këtij Komisioni, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi respektivisht përbërjes së këtij Komisioni.

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësitë e anëtareve të Komisionit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, me plotësim ndryshimet e bëra me Ligjin nr.04/L-111 dhe Ligjin nr.05/L-009, Ligjit nr.02/L-016 për Shoqëritë Tregtare, si dhe aktet tjera ligjore dhe nënligjore përkatëse në fuqi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisje lokale, Ligjit nr.08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, si dhe Rregullores (QRK) nr.03/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Nr.Prot. 01-020/04-0019219/26
Podujevë, datë: 31 mars 2026





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.prot.01-020/04-0019219/26 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës më 31 mars 2026, merr këtë,

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE STACIONI I AUTOBUSËVE PODUJEVË

Neni 1

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, emërohet,

z.Vigan Salihu, U.D. Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik

Neni 2

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

Neni 3

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës nr.prot.01-020/04-0019219/26 të datës 31 mars 2026.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

U dërgohet;
Të emëruarit
Anëtarëve të Komisionit
QSHQ/Arkivit

Nr.Prot. 02-020/04-0026477/26
Podujevë, datë, 05.05.2026

Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi

